



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:093448

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05537777

C.nr.60/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, gjyqtari G. A, në çështjen juridike të paditësve F.B, S.I, H.H, M.S dhe J. A të gjitha nga Gj. të cilat me autorizim i përfaqëson av. M. B nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e N. - DKA, me objekt kontesti kompenzimin e diferencës së pagës për punë në klasë të kombinuara, me datën 03.04.2024 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e F.B, S.I, H.H, M.S dhe J. A të gjitha nga Gj.dhe **detyrohet** e paditura Komuna e N. - DKA, që paditëseve t'ua paguaj diferencën e pagës për punën në klasë të kombinuara 20% të pagës bazë prej 421.00€;
-Paditësja **F.B** për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Qershor 2021, shumën në lartësi prej 1,094.60€, (llogaritur 84.20x13 muaj),
-Paditësja **S. I** për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Tetor 2021, shumën në lartësi prej 1,431.40€, (llogaritur 84.20x17 muaj),
-Paditësja **H. H** për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Nëntor 2022, shumën në lartësi prej 2,526.00€, (llogaritur 84.20x30 muaj),
-Paditësja **M. S** për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Nëntor 2022, shumën në lartësi prej 2,526.40€, (llogaritur 84.20x30 muaj)
-Paditësi **J.A** për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Nëntor 2022, shumën në lartësi prej 2,526.40€, (llogaritur 84.20x30 muaj), duke llogaritur kamatën prej 8% nga data 19.09.2023, data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet përfaqësuesi i paditëseve, që të paguaj taksën shtesë për precizim të padisë, në shumën prej **80.00€**, në afat prej 15 ditëve, konform nenit 12.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 1/2017, Për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

III. Detyrohet e paditura Komuna e N.-DKA, që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 724,00 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditëset përmes përfaqësuesit të tyre, më dt.19.09.2023, kanë ushtruar padi, ndaj të paditurës Komuna e N.-DKA, ndërsa me datën 25.03.2024, kanë bërë precizimin e padisë, me bazë

juridike që paditëseve t'iu paguhet diferencen prej 20%, për punën e bërë, në klasa të kombinuara, paditësja F. B për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Qershor 2021, shumën në lartësi prej 1,094.60€, (llogaritur 84.20x13 muaj), paditësja S. I për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Tetor 2021, shumën në lartësi prej 1,431.40€, (llogaritur 84.20x17 muaj), paditësja H.H për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Nëntor 2022, shumën në lartësi prej 2,526.00€, (llogaritur 84.20x30 muaj), paditësja M. S për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Nëntor 2022, shumën në lartësi prej 2,526.40€, (llogaritur 84.20x30 muaj), paditësi J. A për periudhën kohore, Maj 2020 deri më Nëntor 2022, shumën në lartësi prej 2,526.40€, (llogaritur 84.20x30 muaj), duke llogaritur kamatën prej 8% nga data 19.09.2023, data e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor. Kërkesën e ka mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës respektivisht neni 11 pargraf 4. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar .

E paditura më dt.25.02.2020, në gjykatë kishte ushtruar përgjegj në padi, duke shtuar se e kundërshtoj në tërësi padinë e paditëseve, pasi që nga themelimi e paditura nuk ka paguar asnjërin nga punëtorët e arsimit për shpenzime të udhëtimit dhe shujtave .Kontrata e përgjithshme Kolektive nga viti 2017 dhe 2021, nuk paraqet bazë ligjore për këto kërkesa sepse egziston njoftimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës – MASH-TI nr ,OIB /488 nga 21 Nëntor 2022 për shkeputjen Kontrates Kolektive të datës 20 Janar 2021 , e cila i'u është percjell SBASHK-UT .Në bazë të nenit 77-79 të Ligjit të Punës dhe nenit 74 të Ligjit për Shërbyesit Publik ,paditësit kanë pasur për obligim ti drejtohen autoritetit të shkallës së parë dhe pas marrjes së përgjigjes negative atëherë të ushtrojnë padi në gjykat.

Gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim, me të cilën e refuzon në tërësi si të pabazuar, si dhe të paditurës ti kompeztoj shpenzimet e procedurës .

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje kontestuese i ka administruar këto prova materiale:

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës të datës 07.06.2017, u vërtetua fakti se paditësja F.B ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e N.-DKA më dt.07.06.2017, për kohë të pacaktuar, ku e njëjta sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënëse në SHFMU “M.i”P.N.F në fshatin V. K. N., titulli i punës arsimtare klasore, me pagë mujore 405.00€ në muaj , fondi i orëve 20.

Nga leximi i vërtetimit të SHMFU “M.” në N. i datës 22.03.2024 , për punë me klasë të kombinuara u vërtetu fakti se paditësja F.B për periudhën kohore 09.06.2017 deri 16.06.2021 punon në shkoll me klasë të kombinuara (1-3 dhe 2-4).

Nga Lista e pagave për muajin Maj 2022, u vërtetua fakti se paditësja F. B ka pagën neto 438.98€.

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës të datës 13.11.2018, u vërtetua fakti se paditësja S. I ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e N.-DKA më dt.13.11.2018, për kohë të pacaktuar, ku e njëjta sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënëse në SHFMU “M.”P.N.F në fshatin V. K. N, titulli i punës arsimtare klasore, me pagë mujore 405.00€ në muaj , fondi i orëve 20.

Nga leximi i vërtetimit të SHMFU “M..” në N. i datës 22.03.2024 , për punë me klasë të kombinuara u vërtetu fakti se paditsja F. B për periudhen kohore 14.11.2017 deri 25.10.2021 punon në shkoll me klasë të kombinuara (1-3 dhe 2-4).

Nga Lista e pagave për muajin Maj 2022, u vërtetua fakti se paditësja S. I ka pagën neto 438.98€.

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës të datës 11.12.2018, u vërtetua fakti se paditësja M. S ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e N.-DKA më dt.11.12.2018, për kohë të pacaktuar, ku e njëjta sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënëse në SHFMU “M..”P.N.F në fshatin V. K. N, titulli i punës arsimtare klasore, me pagë mujore 421.20€ në muaj , fondi i orëve 20.

Nga leximi i vërtetimit të SHMFU “M...” në N. i datës 22.03.2024 , për punë me klasë të kombinuara u vërtetu fakti se paditsja M. S për periudhen kohore 01.01.2018 deri 21.11.2022 punon në shkoll me klasë të kombinuara (1-3 dhe 2-4).

Nga Lista e pagave për muajin Maj 2022, u vërtetua fakti se paditësja M. S ka pagën neto 438.98€.

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës të datës 06.02.2017, u vërtetua fakti se paditësja H. H ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e N.-DKA më dt. 06.02.2017, për kohë të caktuar, deri më datën 31.08.2017 ku e njëjta sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënëse në SHFMU “M..”P.N.F në fshatin V. K. N, titulli i punës arsimtare klasore, me pagë mujore 405.00€ në muaj , fondi i orëve 20.

Nga leximi i vërtetimit të SHMFU “M..” në N. i datës 22.03.2024 , për punë me klasë të kombinuara u vërtetu fakti se paditsja H. H për periudhen kohore 18.04.2017 deri 21.11.2022 punon në shkoll me klasë të kombinuara (1-3 dhe 2-4).

Nga Lista e pagave për muajin Maj 2022, u vërtetua fakti se paditësja H. H ka pagën neto 331.25€.

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës të datës 01.09.2015, u vërtetua fakti se paditësi J. A ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e N.-DKA më dt. 01.09.2015, për kohë të pacaktuar, ku i njëjti sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënës në SHFMU “M..”P.N.F në fshatin V. K. N, titulli i punës arsimtar klasore, me pagë mujore 405.00€ në muaj, fondi i orëve 20.

Nga leximi i vërtetimit të SHMFU “M..” në N. i datës 22.03.2024 , për punë me klasë të kombinuara u vërtetu fakti se paditsi J. A për periudhen kohore 18.04.2017 deri 21.11.2022 punon në shkoll me klasë të kombinuara (1-3 dhe 2-4).

Nga Lista e pagave për muajin Maj 2022, u vërtetua fakti se paditësja J.A ka pagën neto 442.57€.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigjja në padi

rezulton qartas se padia e paditëses është e themeltë. Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara në mbështetje të nenit 398 të LPK-së. Gjykata, para se të vendosë në mënyrë meritore në këtë çështje kontestuese, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe se e njëjta udhëton nga fsh.Ll. deri në N. dhe anasjelltas për të shkuar në vendin e saj të punës në SHFMU ”M...” në N.

Andaj, gjykata, në këtë çështje kontestuese sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 11 paragrafi 4 të kësaj Kontrate, ku shprehimisht është paraparë se punonjësit arsimor që punojnë në klasë të kombinuara duhet të kompenzohen për 20% mbi pagën e rregullt .

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata e datës 22.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Për gjykatën, edhe pretendimi se paditësja nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative është i pabazuar, pasi e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare e me ligj, dhe në rastet e paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/7-212) sipas të cilit nen parashihet se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Kamata ligjore prej 8% në vite është përcaktuar në mbështetje të nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën” kurse lartësia e kamatës vonesë është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore në mbështetje në mbështetje të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 624.00€, duke marrë perbazë se janë 5 paditës dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 100.00€, e në shumën e përgjithshme prej 724.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, si dhe në nenin 143 të LPK-së , gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:093448
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05537777

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm
–Divizioni Civil
C.nr 60/2023, më datë 03.04.2024**

**Gjyqtari,
G.A**

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.